



©Copyright KOMF



A PO ARRIJNË TEK FËMIJËT NË NEVOJË PARATË E TAKSAPAGUESËVE?

Analizë e shkurtër buxhetore mbi politikat
e mbrojtjes sociale për fëmijët në Kosovë

Prill 2014

Ky publikim nuk reflekton domosdoshmërisht
qëndrimet e donatorëve të KOMF.

Ky publikim nuk mund të shitet ose të përdorët
për qëllime përfitimi.

Foto: Leonora Aliu/KOMF

Rruga: Zenel Salihu
Ob.1, Hy.1, K.3, Nr.16, 10000
Prishtinë, Kosovë

info@komfkosova.org
www.komfkosova.org
Facebook: KOMF
Twitter: @komfkosova

A PO ARRIJNË TEK FËMIJËT NË NEVOJË PARATË E TAKSAPAGUESËVE?

Analizë e shkurtër buxhetore mbi politikat
e mbrojtjes sociale për fëmijët në Kosovë

Përmbajtja

Analizë e shkurtër buxhetore mbi politikat e mbrojtjes sociale për fëmijët në Kosovë	1
Shkurtesat	4
1. Hyrje	5
2. Konteksti politik dhe social	6
3. Mbrojtja sociale dhe fëmijët	7
4. Korniza ligjore komunale	7
4.1 Financimi i mirëqenies sociale sipas KASH 2014 – 2016	8
4.2 Financimi aktual i shërbimeve sociale	8
4.3 Modalitetet për financimin e shërbimeve sociale (QPS)	12
5. Sistemi aktual i skemave sociale	14
5.1 Financimi i skemave sociale dhe pensioneve	14
6. Format alternative të mbrojtjes për fëmijët pa përkujdes prindëror	15
6.1 Strehimi familjar	15
6.2 Strehimi rezidencial për fëmijë.....	17
7. Transferet sociale për fëmijë	19
7.1 Skema për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme	19
7.2 Skema e Asistencës Sociale	20
8. Përmbledhje e rekomandimeve	22

Shkurtesat

AKP	Agjensioni Kosovar për Privatizim
DKSHMS	Drejtorati Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
DMS	Departamenti i Mirëqenies Sociale
ILO	Organizata Botërore e Punës
KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
LFPL	Ligji i Financave të Pushtetit Lokal
LVQL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MF	Ministria e Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
QPS	Qendra për Punë Sociale
SAS	Skema e Asistencës Sociale
THV	Të Hyrat Vetanake
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

1. Hyrje

Analiza buxhetore mbi politikat sociale për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë ka për qëllim të shtjellojë financimin e politikave aktuale të mirëqenies sociale, me theks të veçantë në mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë. Njëkohësisht, të ndikojë në përmirësimin e financimit të shërbimeve dhe skemave sociale përmes ofrimit të opsioneve të mbrojtjes sociale dhe financimit të tyre. Kjo analizë i dedikohet publikut të gjerë, palëve në interes dhe në veçanti hartuesve të politikave sociale dhe financiare.

Metodologjia e përdorur për hartimin e kësaj analize bazohet në analizën e dokumenteve, raporteve dhe ligjeve, të cilat rregullojnë mbrojtjen sociale, përkrahjen sociale dhe në veçanti mbrojtjen e fëmijëve. Për më tepër, është vënë në pah analiza e bazës juridike, e cila e rregullon këtë fushë, duke trajtuar problemet eventuale të shërbimeve, hapësirën fiskale për shërbime dhe skema sociale. Si bazë për krijimin e opsioneve janë përdorur edhe opinionet e grupeve me interes nga këndvështrimet e politikëbërësve, individëve, organizatave qeveritare dhe jo-qeveritare që janë ofrues të shërbimeve në komuna, agjencitë vendore, ndërkombëtare si dhe organizatat anëtare të Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), të gjitha këto të nxjerra nga punëtorja e mbajtur me 2-3 dhjetor 2013.

Në fund të kësaj analize janë dhënë rekomandime konkrete përkitazi me problemet aktuale në fushën e mbrojtjes sociale në Kosovë si: krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm që siguron një ndarje të drejtë të buxhetit për financimin e shërbimeve sociale dhe rekomandime specifike për ndryshimet e skemave që kanë për qëllim mirëqenien e fëmijëve.

Analiza është përpiluar nga Shar Kurtishi, njohës i politikave publike dhe financiare, me kërkesë të KOMF, në kuadër të projektit "Kush Flet për Mua? Aksioni i Përbashkët për Mbrojtjen dhe Avancimin e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë", financuar nga zyra e UNICEF-it në Kosovë, Terre des hommes dhe në partneritet me Save the Children.

Në mënyrë që të kuptohet më lehtë i gjithë dokumenti, në vijim do të sqarojmë kontekstin politik dhe social të shërbimeve dhe skemave sociale, bazën ligjore të financimit komunal, financimin aktual të shërbimeve sociale, financimin e nevojshëm të shërbimeve sociale dhe financimin aktual të skemave sociale si dhe propozime konkrete për ndryshim të skemave sociale.

2. Konteksti politik dhe social

Në Kosovë ekziston një shkallë e lartë e varfërisë dhe papunësisë¹, popullatë e re në moshë si dhe rol i zgjeruar i familjes në sigurimin e mbrojtjes sociale. Kjo ka ndikuar që numri i kërkesve për mbrojtje dhe asistencë sociale të jetë shumë i madh.

Për më tepër, Letra e Bardhë² (2009) ka sqaruar se, përderisa përkufizimet e grupeve në nevojë për mbrojtje sociale mund të ndryshojnë në të gjitha vendet e botës, rasti i Kosovës dhe historia e fundit e saj nga paslufta bënë listën e rreziqeve sociale më komplekse. Këtu përfshihen një numër i madh i grupeve specifike në nevojë për mbrojtje siç janë: fëmijët pa përkujdesje prindërore, fëmijët me sjellje asociale, fëmijët në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale, fëmijët me marrëdhënie të çrregulluara në familje, personat e moshës së shtyrë, personat me aftësi të kufizuara fizike ose mendore, fëmijët e lënë pas dore dhe të keqtrajtuar, fëmijët në rrezik apo viktimat të shfrytëzimit apo abuzimit, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, personat në varësi nga alkooli ose drogat, etj.

Në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare për ata njerëz që ndryshe nuk do të ndihmoheshin në mënyrën, e cila do të respektonte dinjitetin e tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre themelore të bazuara në legjislacionin e Kosovës dhe në konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

Në nivelin e Qeverisë qendrore, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është institucioni përgjegjës për të gjitha politikat dhe çështjet rregullative në lidhje me punën dhe mirëqenien sociale. Departamenti për Mirëqenie Sociale (DMS) është organi kyç në kuadër të MPMS-së që është përgjegjës për shërbimet sociale. Në pajtim me Ligjin për Familjen, Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe memorandumet e mirëkuptimit të nënshkruar mes MPMS, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Ministrisë së Financave (MF), në janar 2009, është transferuar mandati i Qendrave për Punë Sociale (QPS-ve) në komuna. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka mandatin nga qeveritë komunale për të pasur përgjegjësinë mbi çështjet e mirëqenies sociale të komunave dhe bën menaxhimin e Qendrave për Punë Sociale (QPS).

Nën këtë marrëveshje, shërbimet sociale janë në përgjegjësi komunale nën menaxhimin e Drejtorive Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DKSHMS), ndërsa skema e zgjeruar mbetet e centralizuar, shërbimet rezidenciale kanë mbetur nën kontrollin qendror të DMS-së në MPMS.

Qendrat për Punë Sociale ofrojnë dy funksione bazë: ofrimin e shërbimeve sociale dhe ofrimin e ndihmave sociale të përfitimit në të holla.

QPS është përgjegjëse për ofrimin e programeve të mbrojtjes sociale, sikurse:

- I. Shërbime sociale profesionale për individ dhe familje në nevojë sociale (mbrojtja e fëmijëve, viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit, etj);
- II. Shpërndarja e ndihmave sociale për familjet e varfra (Skema e Asistencës Sociale).

1 Shkalla e varfërisë së përgjithshme është 29.7 %, varfëria ekstreme 10.2 %, ndërsa shkalla e papunësisë është 30.9 % - burimet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës 2012

2 Letra e bardhë mbi sfidat e përfshirjes Sociale në Kosovë, Kuvendi i Kosovës, shih:
<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/sociale-ne-kosove.pdf>

3. Mbrojtja sociale dhe fëmijët

Mbrojtja sociale është një politikë kyçe për të mbështetur barazinë dhe drejtësinë sociale dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve. Masat e mbrojtjes sociale fuqizojnë aftësitë e familjeve për t'u kujdesur për fëmijët e tyre. Faktet tregojnë rolin e mbrojtjes sociale në përmirësimin e jetës së fëmijëve, familjeve dhe komunitetit në përgjithësi, shpesh me më shumë ndikim tek më të varfrit dhe më të cenueshmit.

KOMF është i angazhuar për të avokuar për mbrojtje të zgjeruar sociale si pjesë e objektivit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, për të ndihmuar dhe përbushur nevojat e tyre bazë dhe për të zgjeruar mundësitë e tyre për të arritur potencialin e plotë. E drejta në skema sociale, sigurime shëndetsore dhe e drejta për një standard adekuat të jetesës për çdo fëmijë është e përfshirë në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.

Mbrojtja sociale trajton barrierat ekonomike dhe sociale që pengojnë qasjen në shërbime, duke u përqendruar në sektorët më në nevojë dhe duke kontribuar për një shpërndarje më të drejtë të burimeve dhe përfitimeve.

Komponentët thelbësorë të mbrojtjes sociale janë transferet sociale, programet që sigurojnë qasje tek shërbimet sociale, ofrimi i shërbimeve sociale, legjislacioni dhe politikat të cilat sigurojnë barazi dhe jo-diskriminim në qasjen në shërbime sociale të fëmijëve dhe familjeve.

4. Korniza ligjore komunale

Kosova aktualisht ka 38 komuna në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, Ligji për Vetëqeverisje Lokale (LVQL) dhe Ligji i Financave të Pushtetit Lokal (LFPL) të vitit 2008. Me miratimin e Kushtetutës dhe LVQL kompetencat e të gjitha komunave janë rritur edhe pse në mënyrë asimetrike. Në veçanti Kushtetuta dhe LVQL ka zgjeruar komunat me funksionet e veta bazë të cilat përfshijnë tashmë kujdesin primar shëndetësor, arsimin para-shkollor, fillor dhe të mesëm duke u shtuar funksione të reja të tilla si menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale. Përveç kësaj një numër i funksioneve të ushtruara më parë nga Qeveria qendrore si p.sh: pagesat e asistencës sociale tani përkufizohen si "funksione të deleguara", ku zbatimi i politikave transferohet në nivelin komunal.

LFPL parashikon një formulë të bazuar në ndarjen e transfereve qendrore për të siguruar parashikueshmërinë e të hyrave komunale si dhe një masë të barazimit midis komunave. LFPL transferet në komuna i rregullon nëpërmjet tre granteve kryesore: grantit të përgjithshëm, dhe dy granteve specifike – të caktuara për arsimin parauniversitar dhe për shëndetësinë primare. Granti i përgjithshëm ka për qëllim t'iu sigurojë komunave një burim bazë për të mundësuar që ato të kryejnë funksionet e tyre në mënyrë adekuate duke i plotësuar ato me të hyrat e tyre vetanake (THV), të cilat në thelb janë shumë të kufizuara. Ligji siguron që formulat të rishikohen rregullisht, fillimisht dy vite pas miratimit të ligjit dhe çdo tre vite pas rishikimit të parë. Përveç formulave për grantin e përgjithshëm, të arsimit dhe të shëndetësisë të cilat janë të destinuara për financimin e komunave, gjegjësisht funksioneve vetanake, LFPL (nenet: 5, 6, 25 dhe 26), kërkon që Qeveria qendrore të ofrojë transfere shtesë për funksionet e deleguara dhe të zgjeruara. Megjithatë LFPL nuk specifikon se si në këto transfere të llogaritet edhe kostoja e shërbimeve sociale.

4.1 Financimi i mirëqenies sociale sipas KASH 2014 – 2016

Qeveria e Kosovës bazuar në prioritetet dhe strategjitë zhvillimore ka ndarë buxhetin rreth 230 milion EUR për mirëqenie sociale, apo rreth 14.5% të totalit të shpenzimeve të parashikuara për vitin 2014. Në anën tjetër komnatat për financimin e Qendrave për Punë Sociale kanë buxhetuar 3.7 milion EUR nga dy burime të financimit: nga granti i përgjithshëm 2.8 milion EUR dhe të 0.9 milion EUR nga të hyrat vetanake komunale. Vlen të theksohet se financimi nga të hyrat vetanake komunale është shumë më i vogël. Përjashtim bënë viti 2014 ku Komuna e Prizrenit ka ndarë 0.5 milion EUR për investime kapitale. Bazuar në historinë e financimeve kontributi real me të hyra vetanake komunale për financimin e shërbimeve sociale është ndërmjet 0.2 – 0.4 milion EUR në vit.

Tabela 1 - Buxheti sipas KASH 2014-2016

Viti	2014	2015	2016
Buxheti i Kosovës	1,589,324,961	1,610,905,445	1,634,136,531
Buxheti qendror	1,189,823,092	1,209,548,665	1,226,023,568
AKP	11,345,873	11,345,873	9,850,000
Buxheti komunal	388,155,996	390,010,907	398,262,963
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	230,103,930	232,994,930	235,994,930
QPS	3,738,096	4,111,906	4,523,096
TOTAL MPMS + QPS	233,842,026	237,106,836	240,518,026
MPMS në % kundrejt BK	14.5%	14.5%	14.4%
QPS në % kundrejt BK	0.2%	0.3%	0.3%
Të hyrat në nivel vendi	1,430,000,000	1,426,000,000	1,498,000,000
Granti i përgjithshëm 10%	143,000,000	142,600,000	149,800,000

Burimi: Korniza afatmesme e Shpenzimeve, Ministria e Financave 2014 - 2016

4.2 Financimi aktual i shërbimeve sociale

Shërbimet sociale janë kompetencë vetanake komunale dhe bazuar në LPFL financohen nga komnatat përmes dy burimeve të financimit nga granti i përgjithshëm dhe të hyrat vetanake komunale. Granti i përgjithshëm ka për qëllim t'iu sigurojë komunave një burim bazë për të mundësuar që ato të kryejnë të gjitha funksionet³ e tyre në mënyrë adekuate duke i plotësuar ato me THV, të cilat në thelb janë shumë të kufizuara. Granti i përgjithshëm është grant i tipit të mbyllur me 10% të të hyrave të projektuara që të do të duhen të mblidhen në nivel qendror gjatë një viti kalendarik, ndërsa ndarjes për kokë banori i janë shtuar disa parametra shtesë, që në radhë të parë të ndihmojë komnatat e vogla me diversitetin etnik dhe territorial të komunave.

³ Funksione konsiderohen: shërbimet komunale që u ofrohen qytetarëve apo njësitë komunale që krijojnë shpenzime nga zyra e Kryetarit, legjislativi komunal, shërbime në drejtoritë apo zyrat si Shërbime Publike, Urbanizëm, Kadastër, Gjeodezi, Ofiqari, etj

Në aneks të këtij raporti, shpjegohet ndarja e grantit në mënyrën vertikale me katër kriteret bazë dhe më pas ndarja horizontale për secilën Komunë, duke përfshirë kriteret për përcaktimin e grantit të përgjithshëm.

Mirëpo problemi për shërbime sociale fillon po këtu sepse nuk kemi garanci që do të ketë ndarje të mjaftueshme që të sigurohet minimumi i financimit për shërbimet sociale⁴. Sepse nga këtu nuk kemi ndonjë mekanizëm të ndarjes për shërbimet sociale duke ditur se nga këto shuma buxhetojnë të gjitha departamentet për shpenzimet operative dhe kapitale.

Kjo mund të vërehet duke u bazuar në historikun e financimit të shërbimeve sociale dhe kornizën afatmesme të shpenzimeve 2014-2016 ku masa e financimit për Qendrat për Punë Sociale, të cilat kanë lëvizur në këtë formë:

Tabela 2 - Financimi i Shërbimeve Sociale (2009; QB2010/01) dhe financimi aktual 2011-2014

Burimi i financimit / viti (në milion EUR)	2010	2011	2012	2013	2014
Financimi i QPS për shërbime sociale ⁵	2.08	2.01	2.82	2.64	2.67
Diferencë nga viti në vit në €	n/a	-0.07	0.81	-0.18	0.03
Diferencë nga viti në vit në %	n/a	-3.4%	40.3%	-6.4%	1.1%

⁴Parashikime buxhetore sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve

Burimi: Raporti i Shpenzimeve, Departamenti i Thesarit, Ministria e Financave

Ky buxhet për financimin e QPS-ve duke filluar nga koha e transferit nga niveli qendror në komuna, si kompetencë e bartur ku janë transferuar të gjitha asetet përfshirë stafin në vitin 2009 ka pasur një rritje simbolike nga viti në vit dhe që nga viti 2011 është integruar tërësisht si buxhet që të financohet nga granti i përgjithshëm⁶.

Në shikim të parë krijohet përshtypja se financimi në total ka një lëvizje të vogël, gjithmonë bazuar në mundësitë që kanë komunat, mirëpo nëse futemi më thellë në detaje duke analizuar ndarjet komunale për financimin e këtyre shërbime vërehet një tendencë e rënies së buxhetit pa asnjë shpjegim, përkundër faktit se kërkesa për shërbime sociale është në rritje, gjë që nuk aludon në përmirësimin e mirëqenies në këto komuna.

4 MPMS ka zhvilluar mekanizmin për financimin minimal të shërbimeve sociale dhe i është dorëzuar Ministrisë së Financave, mirëpo për shkak se duhet ndryshuar LFPL çështja ka mbetur e pa shqyrtuar me tutje

5 Në këtë buxhet përfshihet edhe kompetenca e deleguar nga niveli qendror i skemës sociale që nënkupton të gjitha shpenzimet për menaxhimin e SAS (kategoritë: paga, mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale) pasi që ky personel vepron brenda QPS. Mirëpo vlen të theksohet se nuk përfshihen pagesat për përfituesit pasi ato menaxhohen nga MPMS

6 Granti i përgjithshëm siguron financimin e të gjitha shërbimeve komunale, me përjashtim të arsimit parauniversitar dhe shëndetësisë primare të cilat financohen nga grantet specifike

Tabela 3 - Ndarja horizontale për komuna dhe diferencat ndërmjet viteve 2011-2014

Komuna	Buxheti 2011 në €	Buxheti 2013 në €	dif 2011/2013 në €	dif. 2011/2013 në %	2014	dif 2013/2014 në €	dif. 2013/2014 në %
Deçan	53,048	53,807	759	▲ 1.4%	53,808	1	▶ 0.0%
Dragash	51,993	54,700	2,707	▲ 5.2%	53,700	- 1 000	▶ -1.8%
Ferizaj	77,724	77,083	9,726	▲ 18.5%	86,978	9 895	▶ 12.8%
Fushë Kosovë	52,540	62,266	9,726	▲ 12.5%	66,735	4 469	▶ 7.2%
Gjakovë	83,016	139,000	55,984	▲ 67.4%	99,977	- 39 023	▼ -28.1%
Gjilan	83,576	96,256	12,680	▲ 15.2%	96,550	294	▶ 0.3%
Gillogoc	67,257	99,750	32,493	▲ 48.3%	74,033	- 25 717	▼ -25.8%
Graçanicë	n/a	36,714	36,714	n/a	23,463	- 13 251	▼ -36.1%
Hani i Elezit	n/a	16,931	16,931	n/a	17,981	1 050	▶ 6.2%
Istog	61,641	67,800	6,159	▲ 10.0%	64,800	- 3 000	▶ -4.4%
Junik	n/a	13,042	13,042	n/a	12,686	- 356	▶ -2.7%
Kaçanik	45,319	53,686	8,367	▲ 18.5%	47,206	- 6 480	▼ -12.1%
Kamenicë	91,214	81,000	-10,214	▲ -11.2%	78,552	- 2 448	▶ -3.0%
Klinë	52,536	59,789	7,253	▲ 13.8%	62,820	3 031	▶ 5.1%
Kllokot	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Leposaviq	Niv.qen.	Niv.qen.	Niv.qen.	Niv.qen.	Niv.qen.	Niv.qen.	Niv.qen.
Lipjan	63,106	76,042	12,936	20.5%	71,042	- 5 000	▶ -6.6%
Malishevë	49,200	98,915	49,715	101.0%	92,962	- 5 953	▶ -6.0%
Mamushë	n/a	9,975	9,975	n/a	9,005	- 970	▶ -9.7%
Mitrovicë	142,296	186,060	43,764	▲ 30.8%	169,813	- 16 247	▶ -8.7%
Novobërdë	28,193	22,688	-5,505	▶ -19.5%	26,516	3 828	▲ 16.9%
Obiliq	55,317	47,256	-8,061	-14.6%	47,356	100	▶ 0.2%
Partesh	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Pejë	80,527	188,500	107,973	▲ 134.1%	187,800	- 700	▶ -0.4%
Podujevë	64,475	87,186	22,711	▲ 35.2%	83,000	- 4 186	▶ -4.8%
Prishtinë	184,708	260,000	75,292	▲ 40.8%	370,000	110 000	▲ 42.3%
Prizren	108,755	225,100	116,345	▲ 107.0%	225,100	0	▶ 0.0%
Rahovec	69,777	78,520	8,743	▲ 12.5%	78,520	0	▶ 0.0%
Ranillug	n/a	17,332	17,332	n/a	17,332	0	▶ 0.0%
Shtërpcë	49,146	49,146	-	▲ 0.0%	49,146	0	▶ 0.0%
Shtime	49,199	63,871	14,672	▲ 29.8%	90,000	26 129	▲ 40.9%

Skenderaj	79,144	101,300	22,156	▲ 28.0%	97,250	- 4 050	▶ -4.0%
Suharekë	61,713	71,000	9,287	▲ 15.0%	71,000	0	▶ 0.0%
Viti	53,648	77,179	23,531	▲ 43.9%	76,031	- 1 148	▶ -1.5%
Vushtrri	58,654	74,343	15,689	▲ 26.7%	74,442	99	▶ 0.1%
Zubin Potok	Niv.qen.	Niv.qen.	Niv.qen.	Niv.qen.	Niv.qen.	Niv.qen.	Niv.qen.
Zveçan	Niv.qen.	Niv.qen.	Niv.qen.	Niv.qen.	Niv.qen.	Niv.qen.	Niv.qen.
GJITHSEJ	1,917,722	2,646,237	738,882	▲ 38.5%	€2,675,604	29 367	▶ 1.1%

Burimi: Qarkore buxhetore 2010/01, 2012/02 dhe 2013/01, Departamenti i Buxhetit Komunal, Ministria e Financave

Për nevojat e kësaj analize, kemi marrë buxhetet nga viti 2011, 2013 dhe 2014 të demonstrojmë një krahasim në vite rreth ndarjes së buxhetit për shërbimet sociale. Në vitin 2011 mund të vërehet një rritje e buxhetit në masë prej 38.5%. Një nga arsyet që ka ndikuar në rritjen e buxhetit llogaritet të jenë trajnimet e bëra gjatë asaj kohe⁷, mirëpo trajnimet kanë tendencë të harrohen ose me ndryshim të personelit ky kapacitet i ngritur humbet.

Për më tepër ky buxhet nuk merr për bazë faktorët bazë si numrin e popullatës, grupmoshat, apo kërkesën e shërbimeve komunale duke e bazuar në koston për shërbime, aq më pak nuk merr për bazë faktorët e rrezikut. Pavarësisht faktit se çdo Komunë ka kërkesa të ndryshme të llojit të shërbimeve bazuar në problemet sociale në të.

Në pamundësi që të sigurohet një mekanizëm i qëndrueshëm për financimin e shërbimeve sociale çështja shndërrohet në problem kritik ekzistencial për mbarëvajtjen e Qendrave për Punë Sociale e për më tepër rrezikohet ofrimi i shërbimeve universale sociale, të cilat përcaktohen me legjislacionin në fuqi, standardet minimale të shërbimeve sociale dhe nga Organizata Botërore e Punës (ILO) e cila në vitin 2012 ka miratuar rregulloren për mbrojtjen sociale Nr. 202 për grupet e rrezikuara me të cilën është vendosur tavanin e ulët për mbrojtjen sociale, që do thotë se duhet mbrojtur hapësira fiskale apo financimi për ofrimin e shërbimeve sociale.

Nëse vazhdohet me këtë formë të financimit gjendja mund të keqësohet për aq sa ta sjellë QPS-në në një qendër jofunkionale, e cila duke mos u financuar mjaftueshëm do të ketë performancë më të ulët ose nuk do të mund të ofrojë shërbime sociale ose do të duhej të bënin kompromis me cilësinë e shërbimeve sociale dhe që në të dyja rastet, në rast të inspektimit bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale mund t'i merret e drejta e ushtrimit të kompetencës dhe kjo të kthehet në nivel qendror.

Në mënyrë që ky funksion komunal të mos mbetet në mëshirë komunale (duke pasur parasysh financimin në vitet e fundit), sugjerohet të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme e financimit brenda Ligjit për Financimin e Pushtetit Lokal. Në vijim do të ju ofrohen dy opsione për financim brenda LPFL.

⁷ Rritje substanciale e buxhetit për vitin 2013, kjo si rezultat i trajnimeve të përbashkëta të mbajtura gjatë mesit të vitit 2012, ku drejtorët të Mirëqenies Sociale, drejtorët e QPS-ve janë aftësuar për parashtrimin e kërkesave dhe mbrojtjen e kërkesave buxhetore dhe në anën tjetër drejtorët e Financave janë informuar më mirë rreth shërbimeve sociale dhe arsyetimin pse duhet ndarë buxheti i kërkuar. Trajnimet janë mbajtur nën patronatin e MPMS dhe financuar nga DFID

4.3 Modalitetet për financimin e shërbimeve sociale (QPS)

Për të siguruar një financim të qëndrueshëm dhe të drejtë të shërbimeve sociale në Kosovë konsiderohet që zgjidhja më e mirë është të bëhet nëpërmjet ndryshimit të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe krijimit të një granti i cili do të duhej të jetë krahas granteve operative⁸ si grant për shërbime sociale. Ky grant do të duhej të ketë kritere të qarta që të siguroj ndarje të drejtë dhe financim adekuat për shërbimet sociale.

Prandaj ne ofrojmë dy alternativa për të siguruar një financim të qëndrueshëm dhe të drejtë të shërbimeve sociale.

Alternativa e parë: Grant specifik për shërbimet sociale i llojit të mbyllur⁹, e cila është alternativa më adekuate për arsye se siguron një minimum të qëndrueshëm të ofrimit të shërbimeve sociale;

Alternativa e dytë: Ndarje e dedikuar për shërbime sociale në përqindje brenda grantit të përgjithshëm¹⁰. Duhet cekur që alternativa e dytë nuk garanton siguri financiare në masë sikurse alternativa e parë.

Hipotezat për ndarje financiare në alternativat në vijim janë bërë duke supozuar nivelin e të hyrave të nivelit qendror, atë të vitit 2014 me 143,000,000 EUR sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2014-2016.

Alternativa e parë: si grant specifik do të ndahej në variantin e parë 0.2% ose në variantin e dytë 0.25% nga niveli i të hyrave qendrore të planifikuara që në vlerë nominale është 2.86 Milion EUR ose 3.57 Milion EUR. Kësisoj varianti i 0.2% do të mund të mbulojë financimin minimal të shërbimeve sociale, ndërsa në variantin e dytë me 0.25% do të mund të financoheshin shërbime sociale bazuar në standardet minimale strukturore dhe funksionale tashmë të aprovuara nga MPMS. Ky model do të kishte ndikim financiar në rritjen e të hyrave komunale për 0.2% ose për 0.25% dhe njëkohësisht zvogëlim për të njëjtën vlerë për nivelin qendror.

Alternativa e dytë: brenda grantit të përgjithshëm pas ndarjes së kriterit 140,000 EUR (shih tabelën Nr.4), do të mbetej 139,877,546 EUR dhe nga kjo do të ndaheshin nga 2% në variantin e parë dhe 2,5% në variantin e dytë.

Varianti i parë në vlerë nominale do të jetë 2.79 Milion EUR dhe varianti i dytë me 3.49 Milion EUR.

Ky model nuk do të kishte ndikim financiar në rritjen e të hyrave komunale apo zvogëlim për nivelin qendror pasi që çdo gjë do bëhej brenda grantit të përgjithshëm.

Pasi të jetë vendosur për ndonjë prej alternativave dhe varianteve brenda tyre, QPS-të dhe shërbimet sociale do të kishin një financim minimal prej 2.79 Milion EUR ose një optimal prej 3.49 Milion EUR.

Kësisoj do të mundësohej ndarja e kësaj vlere në mënyrën horizontale për komuna me kritere specifike të përditësuara nga MPMS në baza vjetore.

Këto ndarje do të siguronin qëndrueshmëri fiskale për financimin e shërbimeve sociale përveç në rastin nëse zvogëlohet mbledhja e të hyrave në nivel qendror.

⁸ LPFL, neni 1, pika 1

⁹ Granti specifik për shërbime sociale do të jetë i pavarur nga grantet tjera dhe i bazuar në disa faktorë të rrezikut sipas komunave të cilët përcaktohen nga MPMS (faktorët si papunësia, nataliteti, divorcet, braktisja e shkollës tek fëmijët, etj) dhe ndërlidhjes me indikatorët si popullata në komuna, grupmoshat, BPV në Komunë, etj. Ky lloj granti kërkon përcaktim e një përqindje nga niveli qendror dhe ajo përqindje do të jetë ndarja nga të hyrat totale të vendit e cila do t'i dedikohet shërbimeve sociale në bazë vjetore

¹⁰ Sigurim që para ndarjes horizontale për komuna të ndahet minimumi i financimit i nevojshëm për shërbime sociale

Tabela 4 - Propozimet për ndarjen brenda grantit të përgjithshëm për financimin e shërbime sociale, sipas alternativës së dytë

Ndarja ekzistuese				Varianti 1	Varianti 2
Shuma totale e grantit për tu distribuar:	A	€ 143,000,000	€ 143,000,000	€ 143,000,000	
Shuma balancuese 140,000 EUR - 1 EUR për kokë banori	€ 140,000	B	€ 3,122,454	€ 3,122,454	
Diferenca e mbetur pas kriterit balancues:	C = A - B	€ 139,877,546	€ 139,877,546	€ 139,877,546	
			2%	2,5%	
Ndarje interne për shërbime sociale			€ 2,797,551	€ 3,496,939	
Mbetja e ndarë për katër kriteret e mëposhtme			€ 137,079,995	€ 136,380,607	
Popullata në %	89%	= C * 89%	€ 124,491,016	€ 121,378,741	
Popullata pakicë	3%	= C * 3%	€ 4,196,326	€ 4,091,418	
Komunat me popullatë minoritare	2%	= C * 2%	€ 2,797,551	€ 2,727,612	
Sipërfaqja komunale	6%	= C * 6%	€ 8,392,653	€ 8,182,836	

Burimi: Ligji i Financave të Pushtetit Lokal, Ministria e Financave

5. Sistemi aktual i skemave sociale

Skemat sociale në Kosovë menaxhohen nga MPMS. Skemat sociale në Kosovë janë të orientuara kryesisht drejt përfitimeve mujore në kesh për familjet e varfra, për personat me aftësi të kufizuar, për strehimin e fëmijëve në strehim familjar dhe rezidencial, për pensionistët, për kategoritë e invalidëve të luftës dhe familjeve të dëshmorëve. Skema e vetme për familjet e varfra është Skema e Asistencës Sociale e cila funksionon në kuadër të QPS-ve si kompetencë e deleguar nga niveli qendror për komunat.

Sipas legjislacionit në fuqi, kategoritë sociale përfitojnë përmes këtyre skemave sociale: Skema e Asistencës Sociale (2000), Skema e Invalidëve të Luftës dhe të Afërmve të tyre (2001), Skema e Pensionit Themelor (2002), Skema e Pensioneve të Trepçës (2003), Skema e Nevojave të Veçanta (2003), Skema e Pensioneve për Aftësi të Kufizuar (2004), Pensionet kontributdhënëse (2008), Skema e Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar (2009).


Mirëpo, fokusi i analizës do të jetë tek skemat të cilat u dedikohen fëmijëve sikurse: strehimi familjar për fëmijët pa kujdes prindëror dhe të braktisur deri në gjetjen e një zgjidhje alternative për fëmijët, strehimin rezidencial, skemën e asistencës sociale dhe skemën për përkrahje familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme.

5.1 Financimi i skemave sociale dhe pensioneve

Numri total i përfituesve nga asistenca sociale dhe sigurimet sociale në fund të vitit 2012 sipas të dhënave të MPMS ishte 215,460 me kosto prej 195.2 Milion EUR, të cilat ndahen në këto kategori (shih grafikun në vijim).

Nëse i heqim pensionet dhe sigurimet tjera sociale (rreth 123.3 Milion EUR) gjithashtu dhe programin e tregut të punës së bashku me masat pasive (8.1 Milion EUR), transferet sociale (me 48,141 përfitues individual dhe familje) mbetet me 63.8 Milion EUR (shih grafikun më poshtë).

Grafika 1 - Përbërja e Skemave Sociale dhe Pensioneve për vitin 2012



Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të dhënat e fundit të disponueshme në vitin 2012

6. Format alternative të mbrojtjes për fëmijët pa përkujdes prindëror

Sipas legjislacionit në fuqi, format alternative të mbrojtjes së fëmijëve pa përkujdes prindëror janë: kujdestaria, stehimi familjar, stehimi rezidencial dhe adoptimi. Sipas të dhënave nga sistemi informativ i menaxhimit të të dhënave pranë MPMS deri në fund të vitit 2013 janë gjithsej 1285 fëmijë pa përkujdesje prindërore.

Procesi i përkujdesjes sociale si stehimi familjar dhe rezidencial rregullohet me Ligjin Nr.04/L-081 për Shërbimet Sociale dhe Familjare. Të dyja llojet e kujdesit si ai familjar apo rezidencial konsiderohen si kujdes i përkohshëm deri në zgjidhjen e statusit final të fëmijës.

Për statusin e përkohshëm kërkohet vendosja e kujdestarisë. Në mënyrë që të iniciohet kujdestaria ligji i kërkon QPS-së që në emër të organit të kujdestarisë të përkujdeset dhe është e obliguar të veprojë çdo herë si prind i mirë ndaj një fëmije që është bonjak pa të dy prindërit, që është dhënë për adoptim nga prindi ose prindërit e tij, që është braktisur, të cilit nuk i dihen prindërit, që i është dhënë QPS-së në përkujdesje të përkohshme nga prindi ose prindërit e tij dhe që i është dhënë në përkujdesje DMS-së nga ana e Gjykatës. Stehimi familjar tek të afërmit për fëmijët pa kujdes prindëror dhe fëmijë të braktisur, Qeverisë së Kosovës i ka kushtuar 486,900 EUR gjatë vitit 2013, mirëpo kjo shumë mbulon vetëm koston e stehimit familjar tek farefisi për 541 fëmijë. Përveç kësaj, 82 fëmijë janë stehuar në familje strehuese dhe 150 fëmijë në kujdes rezidencial, kostoja e kësaj të fundit mbulohet nga agjencione të huaja apo organizata jo-qeveritare dhe MPMS.

Tabela 5 - Kalkulimi i kostos për stehim familjar dhe rezidencial

Lloji i stehimit	Numri i fëmijëve deri me 31/12/2013	Kostoja vjetore	Kostoja totale
Fëmijë të stehuar në farefis (75 EUR në muaj)	541	€ 900	€ 486,900
Fëmijë të stehuar në familje strehuese (150 EUR në muaj)	82	€ 1,800	€ 147,600
Fëmijë të stehuar në stehim rezidencial (640 EUR në muaj, sipas Koalicionit të Stehimoreve)	150	€ 7,680	€ 1,152,000

Departamenti i Mirëqenies Sociale, MPMS

6.1 Stehimi Familjar

Interesi më i mirë i fëmijës përmbushet kur nevojat e zhvillimit fizik dhe psikologjik plotësohen brenda kontekstit të familjes të tij/saj. Çdo përpjekje duhet të bëhet që të promovohet mirëqenia e fëmijës në suaza të familjeve të tyre biologjike. Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve thekson qartë, që të gjithë fëmijëve, përfshirë fëmijët e braktisur, fëmijët me nevoja të veçanta dhe të keqtrajtuar duhet t'iu mundësohet të jetojnë në familje. Formave alternative të mbrojtjes sikurse stehimi familjar duhet t'i jepet gjithmonë përparësi në raport me stehimin rezidencial.

Strehimi familjar ndahet në dy lloje: strehimi tek të afërmit dhe strehimi në familje strehuese alternative.

Sipas akteve nënligjore, është përcaktuar që familjet strehuese që ofrojnë strehim për fëmijët pa përkujdesje prindërore, e që janë farefis me fëmijën të marrin 75 EUR për fëmijë në muaj. Ndërsa familja që strehon fëmijë të braktisur, e që nuk janë farefis i fëmijës, marrin 150 EUR për fëmijë në muaj. Kjo shumë dallon për fëmijët me aftësi të kufizuara të strehuar në familje strehuese ku familjet në emër të përkujdesjes për fëmijët marrin nga 250 EUR në muaj për fëmijë.

Këto familje strehuese të gjitha trajnohen nga stafi profesional i QPS-ve dhe organizatave të tjera që ofrojnë shërbime sociale. Megjithatë QPS-të kërkohet që të punojnë tutje në sensibilizimin e familjeve potenciale strehuese të tjera që të bëhet një shtrirje gjeografike më e mirë.

Strehimi familjar nuk është i shtrirë në gjithë Kosovën, ka shtrirje në vetëm 22 komuna nga gjithsej 38 komuna sa ka Kosova. Nuk ka një kategorizim të strehimit familjar sipas kategorive të fëmijëve, për sa i përket pagesave për familjet strehuese. Pagesa për fëmijët në strehim familjar pavarësisht nevojave të tyre të ndryshme (kategoritë, moshën) është e njëjtë dhe gjithashtu e pa mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e përkujdesjes për fëmijën. Familjet strehuese nuk realizojnë asnjë përfitim social apo shëndetësorë në emër të qenurit familje strehuese dhe në këtë mënyrë rrezikohet qëndrueshmëria e tyre.

Shihet qartë që strehimi familjar është dukshëm më i lirë se strehimi rezidencial. Strehimi në farefis është afër 11 herë më i lirë se strehimi rezidencial dhe 5 herë më i lirë se strehimi në familje strehuese. Përveç koston më të lirë janë benefitet tjera psikosociale tek fëmijët, model i cili mund të thuhet se është integruar dhe më i miri për zhvillimin tërësor të fëmijës në familje.

Rekomandime:

- Familjet strehuese të cilat janë në pritje për të strehuar fëmijë, të financohen me 50% të vlerës bazë. Financim ky, i cili do t'i mbajë të motivuara familjet strehuese edhe gjatë kohës kur janë në pritje, domethënë gjatë kohës që nuk kanë fëmijë;
- Rritja e vlerës bazë, kjo bazuar në shportën e konsumit dhe indeksin e inflacionit të çmimeve të konsumit;
- Përshkallëzimi i shumës së pagesës së strehimit familjar, bazuar në moshën dhe nevojat e fëmijëve;
- Rekomandohet që familjet strehuese të realizojnë përfitime sociale apo shëndetësore në emër të të qenurit familje strehuese. Në vende të zhvilluara të qenit familje strehuese kryefamiljarit i njihet edhe si përvojë pune.

6.2 Strehimi rezidencial për fëmijë

Sipas të dhënave ekzistuese të sistemit informativ të MPMS-së deri në fund të vitit 2013 në strehim rezidencial janë strehuar gjithsej 150 fëmijë¹¹.

Kostoja mesatare e një fëmije për qëndrim vjetor në kujdes rezidencial është 7,500 EUR¹² që përfshinë banimin, ushqimin bazë, dhe përkujdesje profesionale institucionale. Kostoja vjetore për ofrimin e shërbimeve për 150 fëmijë në strehim rezidencial është 1,006.080 EUR, shumë e cila mbulohet nga agjenci dhe organizata të huaja dhe vetëm pjesërisht mbulohet nga MPMS me subvencionim prej 25,000 EUR në bazë vjetore.

Aktualisht në Kosovë në emër të blerjes së shërbimeve sociale për strehim të përkohshëm MPMS përmes procesit të tenderimit mbështetin:

- Gjashtë OJQ që strehojnë viktime gra dhe fëmijë të dhunës në familje. Strehimi zgjat aq sa shërbimi social arrin që të bëjë ribashkim familjar ose të sigurojë forma tjera alternative të mbrojtjes. Strehimoret marrin nga 2,000 EUR në muaj;
- Një OJQ që strehon dhe rehabiliton viktimat e trafikimit (PVPT), që financohet nga MPMS me 2,500 EUR në muaj;
- Një OJQ që strehon fëmijë të keqtrajtuar, të lënë pas dore dhe viktime të trafikimit me shkallë të ulët të rrezikshmërisë, që financohet nga MPMS me 4,891.60 EUR në muaj.

Në përgjigje ndaj numrit të fëmijëve të cilët kanë nevojë për përkujdesje, shumë qendra rezidenciale që janë pjesë e sektorit jo-qeveritar ballafaqohen me sigurimin ekzistencial apo qëndrueshmërinë financiare duke rrezikuar ofrimin e këtyre shërbimeve.

Andaj kërkohet që pragu i minimumit të financimit të rritet nga 25,000 EUR në 50,000 EUR si dhe të merret si shembull modeli¹³ i financimit të shpenzimeve komunale si ujë, rrymë, nxehje dhe mbeturina. Arsyeya e rritjes është të sigurohet mbarëvajtja e funksionimit, qëndrueshmëri, si dhe shërbime më kualitative.

Fëmijët të cilët strehohen në strehim rezidencial janë kryesisht fëmijë viktime të dhunës në familje dhe fëmijë viktime të trafikimit me rrezikshmëri të ulët, mesme dhe të lartë, të cilët vlerësohen që nuk mund të shkojnë në strehim familjar. Meqenëse krahas MPMS, dhuna në familje dhe trafikimi me qenie njerëzore trajtohen nga dikastere të ndryshme sikurse Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë, rekomandohet që krahas financimit nga MPMS, të krijohet një vijë buxhetore në kuadër të Qeverisë së Kosovës, ku do të derdheshin mjete nga të gjitha ministrinë e përfshira me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë për ofrimin e shërbimeve kualitative për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit të strehuara në strehim rezidencial.

Aktualisht shërbimet me bazë në komunitet, konkretisht përmes qendrave të kujdesit ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe kategoritë tjera të cenueshme, janë duke u ofruar në katër komuna: Pejë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan.

11 Fëmijët e strehuar në strehim rezidencial sikurse: SOS Fshatrat e Fëmijëve, strehimoren "Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijë", strehimoret për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në: Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Prizren dhe Gjakovë, Karitas, Shtëpia e sigurtë

12 Kosto sipas Koalicionit të strehimoreve të Kosovës

13 Qeveria komunale e Gjilanit i mbulon këto shpenzime operative për Shoqatën e Mbrojtjes së të drejtave të Gruas dhe Fëmijës – Liria

Themelimi dhe funksionalizimi i qendrave të kujdesit ditor që ofrojnë shërbime psikosociale dhe rehabilituese për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe kategori tjera të cenuara, është iniciativë e MPMS, në bashkëpunim me dy organizata jo qeveritare dhe më mbështetje të donatorëve ndërkombëtarë.

Komunat ku aktualisht ofrohen këto shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe kategoritë tjera të cenuara të fëmijëve, obligohen që pas përfundimit të këtij projekti që mbështet shërbimet psikosociale dhe rehabilituese që ofrohen në kuadër të Qendrave të Kujdesit Ditor, të vazhdojnë t'i mbajnë këto shërbime përmes sigurimit të buxhetit komunal vetanak.

Kostoja vjetore e llogaritur për funksionimin e një qendre të kujdesit ditor sipas modelit aktual, llogaritet të jetë 52,000.00 EUR, duke përfshirë shpenzimet operative sikurse pagat e stafit, shpenzimet komunale, aktivitetet avokuese, ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe organizimin e aktiviteteve rekreative për fëmijët përfitues të shërbimeve në kuadër të qendres së kujdesit ditor, e cila ofron shërbime për rreth 120 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe 40 nga kategoritë tjera të cenuara si fëmijë të neglizhuar dhe viktimat të dhunës në familje, në baza vjetore.

Rekomandohet që komunat të lidhin kontrata me organizatat jo-qeveritare të licencuara dhe të dëshmuara në përvojë dhe profesionalizimin e tyre në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, në emër të komunës, me kusht që kontratat e tilla të jenë në pajtim me planet vjetore të komunës për shërbime sociale dhe familjare në territorin e tyre.

Rekomandime:

- Kërkohet që pragu i minimumit të financimit në strehim rezidencial nga MPMS të rritet nga 25,000 EUR në 50,000 EUR. Me këtë ndihmë do të mund të sigurohet qëndrueshmëri dhe shërbime më kualitative;
- Rekomandohet që krahas financimit nga MPMS, të krijohet një vijë buxhetore në kuadër të Qeverisë së Kosovës, ku do të derdheshin mjete nga të gjitha ministrinë e përfshira me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë për ofrimin e shërbimeve kualitative për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit të strehuara në strehim rezidencial;
- Rekomandohet që komunat të lidhin kontrata me organizatat jo-qeveritare për ofrimin e shërbimeve të veçanta sociale dhe familjare brenda territorit të tyre, në emër të komunës, me kusht që kontratat e tilla të jenë në pajtim me planet vjetore të Komunës për shërbime sociale dhe familjare në territorin e saj.

7. Transferet sociale për fëmijë

Transferet kryesore sociale ku ndërlidhen përfitimet në të holla, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve janë:

- Skema e asistencës sociale;
- Skema për përkrahje materiale familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme.


7.1 Skema për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme

Në fushën e mbrojtjes sociale ekziston Ligji Nr. 03/L-022 për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme, ligji i cili ka shënuar një hap të rëndësishëm në mbështetjen e këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre, por që nuk garanton mbrojtje gjithëpërfshirëse. Kjo skemë parasheh mbështetje financiare mujore prej 100.00 EUR për familjen që ka fëmijë me aftësi të përhershme të kufizuara. Sipas Ligjit Nr. 03/L-022 "Fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme fizike, mendore dhe shqisore", konsiderohen fëmijët nga lindja deri në moshën 18 vjeçare me vendbanim të përhershëm në Kosovë, të cilët janë plotësisht të paaftë të kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore pa kujdesin e personit tjetër.

Numri i fëmijëve që e gëzojnë këtë të drejtë aktualisht në Kosovë është 3013. Ky numër ndryshon varësisht nga kërkesat që parashtrihen nga QPS-të.

Skema në fjalë llogaritet të jetë diskriminuese për fëmijët me aftësi të kufizuara, pasi njeh të drejtën në kompensim material vetëm për fëmijët që kanë aftësi të përhershme të kufizuar duke mos përfshirë fëmijët me aftësi të pjesshme të kufizuara. Poashtu shumica e ofruar sipas këtij ligji, rezultojnë të jetë e pamjaftueshme për nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme.

Grafika 2 - Numri i familjeve dhe kostoja financiare



Rekomandim:

- Amandamenti i Ligjit për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme. Legjislacioni duhet të realizojë mbrojtje gjithëpërfshirëse, duke përfshirë dhe fëmijët me aftësi të pjesshme të kufizuara. Meqenëse kjo do ngërthente kosto financiare shtesë, rekomandohet që MPMS duhet të analizojë gjendjen aktuale dhe të planifikojë mjete financiare shtesë për çështjen në fjalë.

7.2 Skema e Asistencës Sociale

Skema e Asistencës sociale ka për qëllim garantimin e sigurisë sociale në kuadrin e gjerë të mbrojtjes sociale në Kosovë, në mënyrë që të lehtësohet varfëria me anë të ndihmave sociale për familjet në gjendje të nevojës sociale.


Kjo skemë ndahet në dy kategori:

Kategoria e parë: Familja në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë persona të varur dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar.

Kategoria e dytë: Familja me një anëtar të aftë për punë, me të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeç, me një jetim nën përkujdesje të përhershme nën moshën 15 vjeç. Të gjithë anëtarët e familjes ose duhet të jenë të varur sipas ligjit ose duhet të jenë të regjistruar si të pa punë në Zyrën e punësimit.

Këto dy skema në fund të vitit 2013 kanë pasur 29,688 përfitues. Rënia e përfituesve është si rezultat i të dhënave të këtyre familjeve të cilat janë evidentuar se nuk kanë përmbushur kriteret për të hyrë në mbrojtje sociale dhe si rezultat është zvogëluar numri total.

Grafika 3 - Numri i përfituesve të skemës sociale dhe kostoja financiare



Hulumtimet tregojnë që skema e asistencës sociale nuk është e mirë adaptuar që të kontribuojë në zbutjen e varfërisë në përgjithësi dhe posaçërisht në zbutjen e varfërisë së fëmijëve në Kosovë. Shuma mesatare mujore e ndihmës sociale prej 65 EUR për familje është shumë e vogël për të përballuar kushtet elementare të jetesës sikurse ushqimin dhe veshmbathjen për një familje.

Megjithëse vitet e fundit buxheti i Kosovës ka pasur rritje, përqindja e buxhetit të ndarë për Skemën e Asistencës Sociale nuk është rritur, përveç futjes së përfitimit shtesë për familjet me fëmijë në kuadër të kësaj skeme, në vlerë prej 5 EUR për secilin fëmijë, në tetor 2012.

Kriteri (i) në Kategorinë e ii, neni 4, ku përcaktohet që familja duhet të ketë të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeç, është diskriminues dhe absolutisht i papranueshëm. Sipas këtij kriteri familjet e varfra që nuk kanë fëmijë nën moshën 5 vjeçare bien në pozitë të pafavorshme, ky kriter përjashton edhe familjet që kanë marrë ndihmë sociale deri sa fëmija ka mbushur moshën 5 vjeç, pikërisht kur fëmija duhet të fillojë të shkollohet dhe rrjedhimisht dhe familja e varfër do të ketë shpenzime edhe më të mëdha.

Varfëria ka ndikim negativ në zhvillimin fizik, psikologjik dhe social tek fëmijët. Investimi në fëmijë është mënyrë e efikase e sigurimit se brezat e tashëm të fëmijëve të bëhen qytetarë të shëndetshëm dhe efikas në të gjitha aspektet. Varfëria e fëmijëve llogaritet si një ndër faktorët potencial për zhvillimin e fenomeneve negative siç janë: braktisja e shkollës, shfrytëzimi, trafikimi, kërkimi i lëmshës, puna e fëmijëve, delikuenca dhe sjelljeve të tjera asociale.

Rezoluta e Parlamentit Evropian B7-0004/2014 për procesin e integritit të Kosovës në BE (2013/2881(RSP), me theks të veçantë në nenin 38 ku flitet për të drejtat e fëmijëve dhe varfërinë e fëmijëve, u bënë thirrje autoriteteve kosovare për të zbatuar plotësisht Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe rekomandon që politikat për varfërinë e fëmijëve të rishikohen, duke përfshirë modifikimin e Skemës së Asistencës Sociale dhe futjen e një benefiti universal për fëmijët.

Rekomandime:

- Rritja e buxhetit për Skemën e Asistencës Sociale, pra rritja e shumës mujore e asistencës sociale për të siguruar mirëqenie dhe përmbushjen e nevojave ushqimore;
- Shfuqizimi i kriterit (i) në Kategorinë ii neni 4, ku përcaktohet që familja duhet të ketë të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare;
- Rekomandim afatmesëm: ofrimi i shtesave për fëmijë, e cila është dokumentuar në shumë vende të botës si instrumenti më efektiv në zbutjen e varfërisë që është zbatuar në pothuajse të gjitha vendet e Evropës Jug-lindore, për të mos folur për ato të BE-së.

8. Përmbledhje e rekomandimeve

Rekomandimet për mënyrën e financimit të shërbimeve sociale

- **Sigurimi i financimit të qëndrueshëm dhe të drejtë të shërbimeve sociale në Kosovë.** Për të arritur këtë rekomandohet që në kuadër të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal të parashihet krijimi i një granti, i cili do të duhej të jetë krahas granteve operative si grant specifik i dedikuar për shërbime sociale. Ky grant do të duhej të ketë kritere të qarta që të siguroj ndarje të drejtë dhe financim adekuat për shërbimet sociale.
- **Të bëhet ndarja e grantit për shërbime sociale sipas njërës nga dy alternativat që KOMF ka propozuar.** Për të siguruar mirëqenien dhe ofrimin e shërbimeve bashkëkohore rekomandohet që LFPL të orientohet sipas njërës nga dy alternativat e KOMF:

Alternativa I: Grant specifik për shërbimet sociale i llojit të mbyllur, është alternativë më adekuate për ofrimin e një minimumi të sigurt të shërbimeve sociale;

Alternativa II: Të bëhet ndarja e dedikuar për shërbime sociale në përqindje brenda grantit të përgjithshëm. KOMF bën me dije që alternativa e dytë nuk garanton siguri financiare në masë sikurse alternativa e parë.

- **Granti specifik për shërbime sociale të jetë i pavarur nga grantet aktuale.** Rekomandohet që granti i kërkuar nga KOMF të ketë kapacitet për sigurimin e ofrimin të shërbimeve sociale, gjithashtu përcaktimi i përqindjes së financimit do duhej të bëhet nga Komisioni i Granteve bazuar në standardet e përcaktuara nga MPMS.
- **MPMS duhet të përcaktojë kriteret dhe faktorët e rrezikut sipas komunave.** Kjo rekomandohet të bëhet duke u bazuar në faktorët sikurse: papunësia, varfëria, nataliteti, divorcet, braktisja e shkollës tek fëmijët, kriminaliteti dhe ndërlidhjes me indikatorët si popullata në komuna, grupmoshat, BPV në komunë, etj.
- **Komunat të lidhin kontrata me organizatat jo-qeveritare të licencuara dhe të dëshmuara me përvojën dhe profesionalizimin e tyre në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, në emër të komunës.** Me kusht që kontratat e tilla të jenë në pajtim me planet vjetore të komunës për shërbime sociale dhe familjare në territorin e tyre.

Rekomandime për skemat sociale për mbrojtjen e fëmijëve në nevojë

- **Rekomandohet që pragu i minimumit të financimit për shërbimet rezidenciale të rritet nga 25,000 EUR në 50,000 EUR në vit.** Në përgjigje ndaj numrit të fëmijëve të cilët kanë nevojë për përkujdesje rezidenciale, shumë qendra rezidenciale që janë pjesë e sektorit jo-qeveritar ballafaqohen me sigurimin ekzistencial apo qëndrueshmërinë financiare duke rrezikuar ofrimin e këtyre shërbimeve. Andaj kërkohet që pragu i minimumit të financimit nga MPMS të dyfishohet.
- **Rekomandohet të krijohet një vijë buxhetore në kuadër të buxhetit të Kosovës për strehimin rezidencial.** Krahas financimit nga MPMS, krijimi i kësaj vije buxhetore ku do të derdheshin mjete nga të gjitha ministritë e përfshira, do të kishte për qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë për ofrimin e shërbimeve

kualitative për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit në strehim rezidencial dhe njëkohësisht të bëhet subvencionimi i shpenzimeve komunale për strehimoret nga komunat si ujë, rrymë, nxehje dhe mbeturina, duke marrë si shembull komunën e Gjilanit.

- **Investimi financiar në përkrahjen e strehimit të fëmijëve tek të afërmit.** Mirëqenia e fëmijës në strehim tek të afërmit mbetet ndër alternativat më të mira dhe njëkohësisht me koston më të ulët për mbrojtjen e fëmijës. Duke pasur parasysh numrin e fëmijëve të strehuar tek të afërmit, përkrahja në vlerë monetare do të ishte investimi në realizimin e interesit më të mirë të tyre. MPMS duhet të sigurojë jo vetëm qëndrueshmëri të kësaj forme të strehimit, por edhe investim në avancimin e saj.
- **Familjet strehuese të cilat janë në pritje për strehimin e fëmijëve pa përkujdes prindëror të financohen me 50% të vlerës bazë.** Strehimi familjar përveç se ka kosto më të ulët si formë e mbrojtjes ka dhe vlerën më të madhe për mirëqenien dhe zhvillimin tërësor të fëmijëve në nevojë strehimi. Kjo do të ndikonte dukshëm në rritjen e numrit të familjeve të reja strehuese për fëmijët pa përkujdes prindëror. Njëkohësisht të bëhet ndarja e shumës së pagesës së strehimit familjar, duke marrë parasysh moshën dhe nevojat e fëmijëve.
- **Ligji për Përkrahje Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme duhet të amendamentohet në mënyrë që të sigurojë mbrojtje gjithëpërfshirëse.** Për këtë rekomandohet të ndryshohet Skema për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme, duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të pjesshme të kufizuara. Meqenëse kjo do ngërthente kosto financiare shtesë, rekomandohet që MPMS të analizojë gjendjen aktuale dhe të planifikojë mjete financiare shtesë për çështjen në fjalë, bazuar edhe në numrin e fëmijëve më aftësi të pjesshme të kufizuara të evidentuar.
- **Plotësim Ndryshimi i Skemës së Asistencës Sociale, duke përfshirë rritjen e buxhetit për skemën e asistencës sociale, për garantimin e mirëqenies së fëmijëve dhe përmbushjen e nevojave ushqimore.** Shfuqizimi i kriterit diskriminues për fëmijët (i) në Kategorinë II neni 4, ku përcaktohet që familja duhet të ketë të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare. Njëkohësisht rekomandim afatmesëm do të ishte: ofrimi i shtesave për fëmijë, e cila është dokumentuar në shumë vende të botës si instrumenti më efektiv në zbutjen e varfërisë së fëmijëve.

**ANEKS 1 – Kalkulimi i grantit të përgjithshëm
dhe integrimi i financimit të shërbimeve sociale**

Kriteret e LFPL	Në praktikë
10% të hyrave të projektuara qendrore buxhetore	<p>Meqë të hyrat e projektuara që mblidhen nga dogana për vitin 2014 sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve janë parashikuar në nivel prej 1,423,000,000 EUR atëherë granti i përgjithshëm është 10% e kësaj shume.</p> <p>Hapi (1) Granti i Përgjithshëm për vitin 2014 në total është në vlerë prej 142,300,000 EUR</p>

Kriteret e LFPL	Në praktikë																																
<p>KRITER (a) shuma fikse prej (140,000 euro minus 1 EUR për kokë banori)</p> <p>Ky është një mekanizëm balancues për komuna që kanë popullatë të vogël apo më pak se 140,000 banorë.</p> <p>Me qëllim balancimi llogaritet 140,000 minus 1 EUR për kokë banori, ose 0 EUR për komunat me popullatë mbi 140,000 banorë.</p>	<p>Shembull:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Komuna</th> <th>1.) Kriteri balancues 140,000 € - popullsia</th> <th>Popullsia komunale sipas regjistrimit të vitit 2011</th> <th>NDARJA për KRITERI (a)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td>y</td> <td>=x-y</td> </tr> <tr> <td>Deçan</td> <td>€ 140,000</td> <td>40 392</td> <td>€ 99,608</td> </tr> <tr> <td>Dragash</td> <td>€ 140,000</td> <td>34 308</td> <td>€ 105,692</td> </tr> <tr> <td>Ferizaj</td> <td>€ 140,000</td> <td>109 899</td> <td>€ 30,101</td> </tr> <tr> <td>Prishtinë</td> <td>€ 140,000</td> <td>201 804</td> <td>€ 0</td> </tr> <tr> <td>...</td> <td></td> <td>....</td> <td>....</td> </tr> <tr> <td colspan="3">TOTALI</td> <td>€ 3,122,454</td> </tr> </tbody> </table> <p>Hapi (2) KRITER A = 3,122,454 EUR</p>	Komuna	1.) Kriteri balancues 140,000 € - popullsia	Popullsia komunale sipas regjistrimit të vitit 2011	NDARJA për KRITERI (a)		X	y	=x-y	Deçan	€ 140,000	40 392	€ 99,608	Dragash	€ 140,000	34 308	€ 105,692	Ferizaj	€ 140,000	109 899	€ 30,101	Prishtinë	€ 140,000	201 804	€ 0	TOTALI			€ 3,122,454
Komuna	1.) Kriteri balancues 140,000 € - popullsia	Popullsia komunale sipas regjistrimit të vitit 2011	NDARJA për KRITERI (a)																														
	X	y	=x-y																														
Deçan	€ 140,000	40 392	€ 99,608																														
Dragash	€ 140,000	34 308	€ 105,692																														
Ferizaj	€ 140,000	109 899	€ 30,101																														
Prishtinë	€ 140,000	201 804	€ 0																														
...																															
TOTALI			€ 3,122,454																														

Kriteret e LFPL	Në praktikë
Diferenca: Granti i përgjithshëm - KRITER (a)	<p>Hapi (3) Diferenca: 143,000,000 EUR - 3,122,454 EUR = 139,877,546 EUR</p>

Kriteret e LFPL		Në praktikë		
Hapi (4) Më pas bëhet ndarja vertikale e grantit të përgjithshëm bazuar në katër kriteret bazë				
A	Shuma totale e grantit për tu distribuar:	A	€	143,000,000
B	Shuma balancuese 140,000 EUR - 1 EUR për kokë banori	B	€	3,122,454
C	Diferenca e mbetur pas Kriterit Balancues:	$C = A - B$	€	139,877,546
D	Popullata në %	89%	$= C * 89\%$	€ 124,491,016
E	Popullata pakicë	3%	$= C * 3\%$	€ 4,196,326
F	Komunat me popullatë minoritare	2%	$= C * 2\%$	€ 2,797,551
G	Sipërfaqja komunale	6%	$= C * 6\%$	€ 8,392,653

Që të bëhet ndarja e grantit në mënyrë horizontale nevojiten këto të dhëna bazë siç është dhënë në tabelën në vijim.

Komuna	Popullsia në Komunë ¹³	Popullata pakicë në Komunë	Popullatë pakicë në nivel Kosove	Sipërfaqja komunale në KM ²
Deçan	40 392	297	0	295
Dragash	34 308	430	0	430
Ferizaj	109 899	345	0	345
Prishtinë	201 804	4 961	0	514
Graçanicë	10 871	2 670	10 871	131
...			
TOTAL	1 798 645	116 599	130 255	10 896

Kriteret e LFPL			Në praktikë					
Hapi (5) Më pas nxirren përqindjet e komunave kundrejt totaleve								
Komuna	Popullsia në komunë	në %	Popullatë pakicë në komunë	në %	Popullatë pakicë në nivel vendi	në %	Sipërfaqja komunale në KM ²	në %
TOTAL	1 798 645	100%	116 599	100%	130 255	100%	10 896	100%
Deçan	40 392	2.2%	297	0.3%	0	0.0%	295	2.7%
Dragash	34 308	1.9%	430	0.4%	0	0.0%	430	3.9%
Ferizaj	109 899	6.1%	345	0.3%	0	0.0%	345	3.2%
Prishtinë	201 804	11.2%	4 961	4.3%	0	0.0%	514	4.7%
Graçanicë	10 871	0.6%	2 670	2.3%	10 871	8.3%	131	1.2%
...							
Komuna	Popullsia në komunë	Ndarja për 140,000 - 1 EUR për kokë banori	Ndarja e popullsisë 89%	Ndarja për popullata pakicë në komunë	Ndarja për popullatë pakicë në nivel vendi	Ndarja për sipërfaqe komunale në KM ²	Totali komunal	
		140000 - 1	89%	3%	2%	6%		
TOTAL	1 798 645	€ 3,122,454	€124,491,016	€ 4,196,326	€ 2,797,551	€ 8,392,653	€ 143,000,000	
Deçan	40 392	€ 99,608	€ 2,795,683	€ 10,689	0	€ 227,224	€ 3,133,204	
Dragash	34 308	€ 105,692	€ 2,374,586	€ 15,475	0	€ 331,208	€ 2,826,962	
Ferizaj	109 899	€ 30,101	€ 7,606,525	€ 12,416	0	€ 265,737	€ 7,914,779	
Prishtinë	201 804	€ 0	€ 13,967,617	€ 178,543	0	€ 395,909	€ 14,542,070	
Graçanicë	10 871	€ 129,129	€ 752,423	€ 96,092	233 482	€ 100,903	€ 1,312,028	
Hapi (6) Kalkulohen rezultatet e nxjerra në hapin 4 duke u shumëzuar me hapin 6. Kësisoj bëhet shpërndarja e grantit të përgjithshëm për komuna								



Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve

KOMF e përbëjnë:

Associazione Amici dei Bambini

Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim - ASTRA

Iniciativa 6

Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me qenie njerëzore MVPT

One to One Children's Fund

One To One Kosova - Qendra e Këshillimit për Familje

Organizata Rinore Akti

Save the Children

Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë

Terre des hommes

World Vision

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

OPFAKKOS

Qendra për Arsim e Kosovës - KEC

Programi për të Drejtat Civile

VoRAE

Rruga: Zenel Salihu
OB.1, HY.1, K.3, Nr.16, 10000
Prishtinë, Kosovë

038 220 287
info@komfkosova.org
www.komfkosova.org
Facebook: KOMF
Twitter: @komfkosova

Dizajni & Shtypi: Elv Studio



Projekti i KOMF
"Kush flet për mua?" mbështetet
nga zyra e UNICEF në Kosovë



mario

KOMF mbështetet
nga projekti Mario



Save the Children